



UNMIK/REG/2005/26
12 maj 2005

RREGULLORE NR. 2005/26

MBI SHPALLJEN E LIGJIT PËR ZHDUKJEN E KORRUPCIONIT TË
MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin e dhënë atij me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh komunikatën e lëshuar nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës më 28 shtator 2004 lidhur me Ligjin mbi zhdukjen e korrupsionit, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 8 shtator 2004, dhe komunikatat tjera të lëshuara më 28 prill 2005 me të cilat konfirmohet miratimi i ligjit mbi zhdukjen e korrupsionit nga Kuvendi i Kosovës më 22 prill 2005 me ndryshimet e kërkuara,

Duke konstatuar se dispozitat e Ligjit nuk i cenojnë kompetencat e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo pushtetin dhe përgjegjësitë e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese dhe statusin, privilegjet e imunitetin e organizatave dhe individëve sipas ligjit në fuqi,

Me anë të kësaj shpall Ligjin mbi ZHDUKJEN e korrupsionit (Ligji nr. 2004/34) të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, që i ashkëngjitet kësaj Rregulloreje, i cili bëhet i plotfuqishëm në ditën e nënshkrimit, me kusht që:

- (a) Në nenin 2, fjala “penal” të zëvendësohet me “kriminal”;
- (b) Në nenin 10.2, fjalët “dhe përmes ftesës direkte për PSSP-në për emërim të plotësisimit të pozitës së dytë” të fshihen;

- (c) Në nenet 13 dhe 31, fjalët “e Kosovës” pas “Gazeta zyrtare” të fshihet;
- (d) Neni 16.3 fshihet dhe
- (e) Titulli i kapitullit 7 ndryshohet si vijon: “Sanksione administrative”.

Këto ndryshime do të paraqiten në tekstin zyrtar përfundimtar të Ligjit.

Nënshkruar sot, më 12 maj 2005

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm